



## **VENDIM MBI PAPANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 4 tetor 2012**

**Numri i lëndës: 2012-03**

**Rexhep dhe Avdush Dobruna**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 4 tetor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 29 mars 2012.

## **II. FAKTET**

1. Parashtruesit e ankesës të quajtur Rexhep Dobruna ("parashtruesi i parë i ankesës") dhe Avdush Dobruna ("parashtruesi i dytë i ankesës") janë babë e birë.
2. Më 4 shtator 1996, parashtruesi i dytë i ankesës ishte përfshirë në një aksident trafiku. Ai gjendej në një traktor kur ishte goditur nga një kamion ku kishte pësuar lëndime të rënda.
3. Parashtruesi i parë i ankesës ka autorizuar avokatin X.M. për ta përfaqësuar atë dhe djalin e tij gjatë negociatave rreth kompensimit me një kompani të sigurimeve. Parashtruesi i parë i ankesës pohon se çështja nuk ishte zgjidhur për shkak të shpërthimit të konfliktit të armatosur të vitit 1999.
4. Më 2 nëntor 2009 prokurori special i Kosovës ka kontaktuar parashtruesin e parë të ankesës dhe e ka njoftuar atë se një Z.M., avokat që dyshohet se ka përfaqësuar parashtruesit e ankesës, kishte marrë një kompensim prej 53.726 euro (pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë euro) për lëndimet e parashtruesit të dytë të ankesës nga kompania e sigurimeve. Parashtruesi i ankesës pohon se ai asnjëherë nuk e kishte autorizuar Z.M për ta përfaqësuar atë dhe djalin e tij.
5. Më 5 korrik 2011 prokurori special ka akuzuar Z.M. dhe dy persona të tjerë në gjykatën e qarkut në Prishtinë për krim të organizuar, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autoritetit, marrje të vendimeve të paligjshme juridike, shpërlarje të parave dhe mashtrim.
6. Më 15 shtator 2011 gjykata, me gjykatësin e EULEX-it si gjykatës për konfirmim rreth kësaj çështje, ka konfirmuar akuzat penale, në mes të tjerash, kundër Z.M. në lidhje me veprën e dyshuar që ka të bëjë me këtë ankesë.
7. Procedurat janë në pritje në gjykatën e shkallës së parë.

## **III. ANKESAT**

8. Pa përmendur ndonjë dispozitë të dokumenteve ligjore të të drejtave të njeriut, parashtruesit e ankesës pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga Z.M., i cili kishte falsifikuar kompetencat e avokatit në mënyrë që të merr kompensimin me para. Ata pohojnë se ai duhet të gjykohet sa më shpejt që është e mundur.

#### IV. LIGJI

9. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
10. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
11. Paneli paraqet se në thelb parashtuesit e ankesës kërkojnë që Paneli të merr masa në mënyrë që të përshpejtoj procedurat që janë në pritje në gjykatën e qarkut në Prishtinë. Prandaj, Paneli ka vendosur ta shqyrtoj ankesën sipas nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (e drejta për gëzimin paqësor të pronës).
12. Paneli rithekson se nuk ka kompetencë të shqyrtoj qoftë aspektet administrative apo juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në renditjen dhe shpejtësinë në të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat. Edhe pse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar për të shqyrtuar ndonjë lëndë, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera, lëndët nga PShDNj nr. 2011-24, *Predrag Lazić*, § 20; 2011-10, *Dejan Jovanović*, § 33.).
13. Prandaj, çështjet që kanë të bëjnë me këtë lëndë nuk hyjnë brenda kornizës së mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.
14. Për më tej, Paneli vëren se nuk është treguar apo argumentuar se parashtuesit e ankesës nuk mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre civile, që ndoshta mund të dalin prej akuzave për përvetësimin e kompensimit nga Z.M. dhe personat e tjerë, pranë gjykatave civile të Kosovës.

#### PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se ankesa është e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese